

Trepça Shqipëri Aksionare
Trepça Joint Stock Company
Trepça Dookřarska Društvo

№ 2221 Data 06-08.2019
Mitrëriq Mitrëriq

"Trepça SHA"

**Raporti i auditorit të pavarur
dhe pasqyrat financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**



Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

20. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen si të lidhura nëse njëra palë e ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me kompanisë.

Në palët e lidhura përfshihet dhe personeli kyç në menaxhimin e kompanisë. Kompenzimet e menaxhmentit per vitin qe perfundon me 31 Dhejtor 2018 jane si vijon:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Menaxhmenti kyq	43,514	44,888

21. Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpalesje në pasqyrat e vecanta financiare.

Përmbajtja**Faqe**

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyra e pozicionit financiar

1

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

2

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar

3

Pasqyra e rrjedhës së parasë

4

Shënimet në pasqyrat financiare

5 – 19

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin dhe aksionarët e Shoqërisë

Mohimi i Opinionit

Ne u angazhuam të auditojmë pasqyrat financiare të Trepça Sh.A, "Shoqërisë", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat përcjellëse financiare të Shoqërisë. Për shkak të rëndësisë së çështjeve madhore të trajtuara në Bazat për Mohim të pjesës së opinionit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për të siguruar një bazë për një opinion të auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Bazat për Mohimin e Opinionit

Siç është shpalosur në shënimin 1 të pasqyrave financiare, këto pasqyra financiare prezantojnë vetëm pozicionin financiar të disa njësive të Shoqërisë (Miniera në Stantërg dhe Miniera në Kishnicë dhe Artanë) dhe jo të Shoqërisë Trepça SHA në tërësi. Këto pasqyra financiare janë të mangëta pasi nuk prezantojnë të gjithë aktivitetin dhe pasuritë e Shoqërisë dhe të gjithë njësive të sajë, dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen që janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe raportimit financiar në bazë të ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe të Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar të cilat janë të aplikueshme në Kosovë. Dhe po ashtu bijen ndesh me ligjin mbi për Trepçën Ligji Nr. 05/L -120 i cili ka hyrë në fuqi me 31 tetor 2016 dhe me statutin e Trepça ShA.

Siç është përcaktuar në ligjin për Trepçën Ligji Nr. 05/L -120 i cili ka hyrë në fuqi me 31 tetor 2016 Shoqëria Trepça është në proceset ristrukturimit dhe të kalimit nga Ndërmarrje Shoqërore nën administrim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit në Shoqëri Aksionare ku 80% e aksioneve janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 20% në pronësi të punëtorëve të saj. Deri më datën e raportimit kërkesat që dalin nga ligji në lidhje me ristrukturimin dhe menaxhimin e shoqërisë nuk janë funksionalizuar në tërësi. Disa nga njësitë e shoqërisë operojnë të pa varura dhe në kundërshtim me ligjin për Trepçën. Për më tepër nuk ka ende një identifikim dhe vlerësim të pronave të shoqërisë dhe nuk është bërë vlerësimi i tyre siç edhe kërkohet në ligjin për Trepçën, po ashtu është kërkesë ligjore që do duhet definuar se cilat nga pronat do të mbesin pronësinë e shoqërisë dhe cilat nga pronat do mbesin në pronësi të Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Ne u emëruam si auditorë të Shoqërisë me date 27 qershor 2019 dhe kështu ne nuk kishim mundësi që të bëjmë vëzhgimin e numërimit fizik të stoqeve, parasë së gatshme, dhe mjeteve themelore në fillim dhe në fund të vitit. Ne nuk ishim të kënaqur me mjete alternative në lidhje me sasinë dhe vlerën e stoqeve, parasë së gatshme, dhe mjeteve themelore të mbajtura dhe të prezantuara në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

Siç është shpalosur në Shënimin 5 të pasqyrave financiare përcjellëse, me 31 Dhjetor 2018 përfshirë në totalin e pronës, impianteve dhe pajimeve të Shoqërisë vlera e tyre është 12,335,193 euro (31 dhjetor 2017; 12,179,150 euro). Pjesa dërmuese e pronës, impianteve dhe pajimeve të Shoqërisë janë shumë të vjetra dhe disa prej tyre nuk janë funksionale dhe për një kohë të gjatë nuk janë në përdorim dhe nuk është bërë ndonjë renovim apo përmirësim i jetëgjatësisë dhe funksionalitetit të tyre. Kompania nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive themelore siç kërkohet për rastet të tilla nga standardet ndërkombëtare të raportimit financiar për të parë diferencën e vlerës së mjeteve themelore kontabël dhe vlerës së tyre të drejt të tregut. Për më tepër, duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban Shoqëria, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të pronës, impianteve dhe pajimeve të Shoqërisë me 31 dhjetor 2018. Regjistri kontabël i pronës, impianteve dhe pajimeve nuk barazon me totalin e pronës, impianteve dhe pajimeve në pasqyrën e pozicionit financiar për EUR 8,413,202.

Siç është shpalosur në shënimin 6 të pasqyrave, stoqet janë në vlerë 738,400 (31 dhjetor 2017: 753,136). Siç kërkohet nga SNK 2, Kompania nuk ka bërë kapitalizimin e shpenzimeve të ndodhura për prodhimin e stoqeve në vlerën e këtyre stoqeve. Si rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse do të kishte qenë i nevojshëm ndonjë rregullim në vlerën e stoqeve apo të kostonë së prodhimeve të shitura.

Ne e kishim të pa mundur që të kemi evidence të mjaftueshme të auditimit dhe të përshtatshme në lidhje me ekzistencën dhe tërësinë e balancave të llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 prej EUR 1,499,657 (31 dhjetor 2017: EUR 3,919,955), ishte e pa mundur të kemi verifikim nga palët e treta.

Për më tepër Shoqëria nuk ka njohur ndonjë provizion për të arkëtueshmet nga Coresteel DMCC në vlerë prej rreth 499,165.47, i cili debitor ka falimentuar. Ne nuk ishim në gjendje për të vlerësuar se a do duhej që të kemi njohje të provizioneve tjera për llogaritë e arkëtueshme dhe në çfarë niveli si pasojë e mungesës së informacionit adekuat.

Siç është shpalosur në shënimin 10 të pasqyrave financiare, bilanci i të hyrave nga grantet e shtyra të Shoqërisë me 31 dhjetor 2018 arrin shumën prej 3,799,232 euro (31 Dhjetor 2017; 3,244,380 euro). Në mungesë të konfirmimeve nga palët e treta dhe duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban Shoqëria, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së detyrimeve afatgjata të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim do të kishte qenë i nevojshëm për të hyrat nga grantet, të njohura në pasqyrën e të ardhurave.

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2018 ishin EUR 2,344,883 (2017: EUR 4,161,799), ne e kishim të pa mundur që të kemi evidence të mjaftueshme të auditimit dhe të përshtatshme në lidhje me ekzistencën dhe tërësinë e balancave të llogarive të pagueshme më 31 dhjetor 2018, respektivisht 2017, ishte e pa mundur të kemi verifikim edhe nga palët e treta.

Shoqëria nuk ka njohur në pasqyrat financiare të saj, detyrimet për rentën minerare të deklaruar ndër vite tek Komisioni për Miniera dhe Minerale i Kosovës sipas ligjit numër 03 L -163 "Për Minierat dhe Minerale" dhe ligjit nr. 04 L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit L-163 për

Minierat dhe Mineralet. Në bazë të të dhënave të prezantuara nga Shoqëria vlera e rentës e pa regjistruar dhe prezentuar në pasqyrat financiare është EUR 7,457,931 (31 dhjetor 2017: EUR 6,580,678). Si rezultat i natyrës së regjistrimeve të mbajtura nga kompania dhe në mungesë të kontrolleve dhe procedurave adekuate, dhe në pamundësi të marrjes së konfirmimeve nga pala përkatëse ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë vlerën e saktë të korrigjimit që do duhej bërë nga shoqëria në pasqyrat financiare me 31 dhjetor 2018 dhe në vitet paraprake përkatëse.

Duke pasur parasysh detyrimet e panjohura për rentën minerare, detyrimet kontingjente të panjohura për rastet ligjore në proces dhe rënien e të hyrave nga shitja e xeheve gjegjësisht operimin me humbje në vlerë prej EUR 2,211,138 për vitin 2018, dhe si rezultat mungesës së likuiditetit, mund të ketë vështirësi financiare që mund të bëjnë që Shoqëria të mos mund të operojë sipas parimit të vijimësisë.

Si rezultat i çështjeve më lartë dhe natyrës së regjistrave kontabël të mbajtur, lëvizjet në shpalosjen e kapitalit tek fitimet e mbajtura nuk barazojnë në vijueshmëri nga viti paraprak për EUR 70,714 (31 dhjetor 2018: EUR 1,627,512).

Si rezultat i këtyre çështjeve në paragrafët e mësipërm, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar nëse ndonjë nga rregullimet mund të ketë qenë mundur dhe të nevojshme në lidhje me stoqet e pa regjistruara, mjeteve themelore të regjistruara ose të paregjistruara, si dhe llogaritë e arkëtueshme dhe te pagueshme, dhe për elementet që përbëjnë pasqyrën e të ardhurave për vitin 2018, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukset monetare.

Nga çështjet komunikuar me të ngarkuarit me qeverisje, kemi përcaktuar ato çështje që janë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Ne përshkruajmë këto çështje në raportin e auditorit përveç kur ligji apo rregullorja e pengon zbulimin publik në lidhje me këto çështje, ose kur, në rrethana shumë të rralla, përcaktojmë që një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat negative e të bërit këtë në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të peshoj më shumë se përfitimet e interesit publik nga komunikimi i tillë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar në vijimësi, shpalosjen, sipas rastit, çështjet që lidhen vazhdimin në vijimësi dhe duke përdorur bazën kontabilitetit për vazhdimin në vijimësi, përveç nëse Menaxhimit ose synon të likuidojë kompaninë ose të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste, përpos për ta bërë këtë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Përgjegjësia jonë është për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të lëshojë raport të auditorit. Megjithatë, për shkak të çështjes përshkruar në Bazat për Mohim të seksionit mendimit të raportit tonë, ne nuk ishim në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për të siguruar një bazë për një opinion të auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare sipas ligjeve dhe standardeve të auditimit, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Audit Group Shpk
SH.P.K.
PRISHTINE

Audit Group Shpk

Rr: Ali Vitia,
Blloku Administrata
10000 Prishtine
Kosove

Prishtinë, Kosovë
29 Korrik 2019

Trepça SHA

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018
(Shumat në Euro)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Pasuria			
Pasuria jo-rrjedhëse			
Toka, Prona dhe pajisjet	5	12,335,193	12,179,150
Gjithsej pasuria jo-rrjedhëse		12,335,193	12,179,150
Pasuria rrjedhëse			
Stoqet	6	738,400	753,137
Të arkëtushmet tregtare dhe të tjera	7	1,499,657	3,919,955
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	793,149	1,914,634
Gjithsej pasuria rrjedhëse		3,031,206	6,587,726
Gjithsej pasuria		15,366,399	18,766,876
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksionar	9	22,808,174	22,808,174
Fitimi i mbajtur		(12,529,886)	(13,669,075)
Fitimi i vitit		(2,211,138)	1,068,475
Gjithsej kapitali		8,067,150	10,207,574
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Te hyrat nga grantet e shtyra	10	3,799,232	3,244,380
Gjithsej detyrimet jo-rrjedhëse		3,799,232	3,244,380
Detyrimet rrjedhëse			
Llogarit e pagueshme tregtare dhe të tjera	11	2,344,883	4,161,799
Detyrimet ndaj të punësuarve dhe tatimeve	12	983,688	1,076,927
Llogari të pagueshme tjera	11	171,446	76,196
Gjithsej detyrimet rrjedhëse		3,500,017	5,314,922
Gjithsej detyrimet		7,299,249	8,559,302
Gjithsej kapitali dhe detyrimet		15,366,399	18,766,876

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar në emër të menaxhmentit më 29 Korrik 2019.

Basri Ibrahim
Basri Ibrahim
Kryeshf ekzekutiv



Hilmi Haxha
Hilmi Haxha
Drejtor financiar

Trepça SHA

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për fund vitin 31 dhjetor 2018
(Shumat në Euro)

	Shënim e	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017
Te hyrat			
Te hyrat nga shitja	13	11,717,793	16,003,378
Te hyrat tjera	13	407,039	323,131
Total		12,124,832	16,326,509
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	15	(12,405,111)	(12,962,739)
Shpenzimet e materialit dhe lendes se pare		(2,990,991)	(3,680,969)
Shpenzimet e zhvleresimit	5	(543,584)	(777,411)
Shpenzimet tjera operative	16	(1,595,533)	(1,389,175)
Gjithsej shpenzimet		(17,535,219)	(18,810,294)
Te ardhurat financiare	14	3,271,280	3,741,392
Shpenzimet financiare		(72,031)	(70,413)
Shpenzimet neto financiare		3,199,249	3,670,979
Fitimi para tatimit		(2,211,138)	1,187,194
Shpenzimi i tatimit në fitim	17	-	(118,719)
Fitimi neto për vitin		(2,211,138)	1,068,475
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			-
Totali i të hyrave gjithëpërfshirëse për vitin		(2,211,138)	1,068,475

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Trepça SHA

Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet ne fund vitin 31 dhjetor 2018

(Shumat në Euro)

	Kapitali aksionar	(Humbjet e akumuluarat) Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Balanca më 1 janar 2017	22,808,174	(12,041,563)	10,766,611
Rregullime	-	(1,627,512)	(1,627,512)
Fitimi neto për vitin	-	1,068,475	1,068,475
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto pas tatimit në fitim	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	1,068,475	1,068,475
Gjendja më 31 dhjetor 2017	22,808,174	(12,600,600)	10,207,574
Rregullime	-	70,714	70,714
Humbja neto per vitin	-	(2,211,138)	(2,211,138)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse, neto pas tatimit ne fitim	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	(2,211,138)	(2,211,138)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	22,808,174	(14,741,024)	8,067,150

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Trepça SHA

Pasqyra e rrjedhës së parasë për fund vitin 31 dhjetor 2018
(Shumat në Euro)

Shënime	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:	(2,211,138)	1,187,194
Fitimi i vitit para tatimit		
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësimi 5	543,584	777,411
Rrjedha operative e parasë para ndryshimeve në kapitalin punues	(1,667,554)	1,964,605
Ndryshimet në stoqe 6	14,737	411,121
Ndryshimet në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera 7	2,420,298	570,347
Ndryshimet në të pagueshmet tregtare dhe të tjera 11	(1,814,905)	(582,627)
Paraja neto nga aktivitetet operative	(1,047,424)	2,363,446
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:		
Blerja e pronës, ndërtesave dhe pajisjeve 5	(677,855)	(310,526)
Rregullime 5	(21,772)	-
Rrjedha neto e parasë e përdorur në aktivitetet investuese	(699,627)	(310,526)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Ndryshimi në detyrimet afatgjata 10	554,852	(719,933)
Rregullime	70,714	(1,627,512)
Rrjedha neto e parasë e përdorur në aktivitetet financuese	625,566	(2,347,445)
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj	(1,121,485)	(294,525)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	1,914,634	2,209,159
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	793,149	1,914,634

Shënimet shoqëruese prej 5 deri 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

1. Informata mbi Kompaninë

Trepça SHA është shoqëri aksionare. Nga data 8 Nëntor 2011 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka shërbyer si administratore e ndërmarrjes Trepça SHA.

Ndërmarrja është themeluar më 3 Shkurt 2006 si Ndërmarrje shoqërore. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes janë: prodhimi i makinave për miniere, prodhimi i akumulatorëve i stacioneve dhe baterive elektrike, riciklimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike, nxjerrja e mineraleve dhe metalit, prodhimi i metaleve të çmuara, tregtia me shumicë e metaleve dhe xeheve, etj.

Numri i punëtorëve të rregullt më 31 Dhjetor 2018 është 1,287 (31 Dhjetor 2017: 1,337).

Bazuar Ligjin për Trepçën Ligji Nr. 05/L -120, që nga 31 tetori 2016 ligji ka hyrë në fuqi dhe sipas ligjit ndërmarrja Trepça është transformuar nga Ndërmarrje shoqërore nën administrimin e Agjensionit Kosovar të Privatizimit në Shoqëri Aksionare ku aksionari kryesorë është Qeveria e Kosovës më 80% të aksioneve dhe 20% të punësuarit.

Statuti i ri i Trepça SHA është aprovuar me datë 22.01.2019. Sipas statutit të ri, njësite e Trepça SHA janë si me poshtë:

- Minierat me Flotacion Trepça - Stan Terg (Fi 690/89), përfshihen edhe vendburimet Melenica. Gjidom, Rashan, Mazhiq, Zijaça dhe Tërsten,
- Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88) përfshihen edhe vendburimet e Ajvalisë, Kishnicë, Badocit, Përroi i ngjyrosur, Kaltrina dhe Çuka e Batllavës;
- Minierat me Flotacion Kopaonik - Laposaviç (Fi 804/89), përfshihen edhe vendburimet Cemac, Bellobërdo, Gomile. Zhuta Perlino, Koporiç dhe Shotarica.

Ne përbërje të Trepça Sh.A. sipas statutit formohen edhe këto njësi biznese:

- Metalurgjia e Plumbit;
- Metalurgjia e Zinkut;
- Industria Kimike;
- Fabrika e Akumulatorëve në Mitrovicë;
- Fabrika e Pajimeve të Procesit;
- Stabilimentet energjetike (Energjetika):
- Laboratori në Zveçan;
- Instituti i plumbit dhe i zinkut
- Kompleksi administrativ i Kishnicës në Prishtinë
- Kompleksi administrativ në Zveçan

Bordi mbikqyres i Trepça SHA eshte aprovuar nga Qeveria e Kosoves me date 4.4 2018 dhe perbehet nga:

Ardian Sylja (Kryesues)

Naser Peci (Anëtar)

Feriz Fetahu (Anëtar)

Xhafer Nuli (Anëtar)

Shyqyri Sadiku (Anëtar)

Esat Peci (Anëtar)

Në qershor 2019, Kryeshefi i Shoqërisë Trepça Sha është emëruar Basri Ibrahimimi.

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

2. Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të adaptuara nga KKRF për Kosovë.

Këto pasqyra nuk përmbajnë transaksionet dhe aktivitetet e shoqërië në tërësi, në këto pasqyra janë të prezantuara vetëm një pjesë e cila operon në pjesën jugore të Mitrovicës (j Miniera e Stantergut dhe Miniera e Artanes dhe që menaxhohet ndaras nga pjesa veriore edhe pse sipas ligjit Trepça njihet si një entitet me të gjitha njësit e saj. Deri me datën e raportimit njësisia e Trepçes në pjesën Veriore të Mitrovicës nuk janë të përgshira në këtë raport financiar.

3. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

3.1 Standardet dhe interpretimet në fuqi për periudhën raportuese

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet të leshuara nga Bordi Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën e raportuese:

Kërkesa të reja aktualisht efektive

Kërkesa të reja aktualisht efektive data e hyrjes në fuqi 1 janar 2018:

- SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët
- SNRF 9 Instrumentet Financiare
- Transferet e Pronës së Investuar (Amendamentet për SNK 40)
- Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 Cikli (Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28)
- KIRFN 22 Transaksione në valutë të huaj dhe parapagim konsideratë

Kërkesat e ardhshme

Me poshte renditen ndryshimet e fundit në SNRF që kërkohen të jenë aplikuar për periudha vjetore që fillojnë pas 1 janarit 2018 dhe që janë në dispozicion për adoptim të hershëm në periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018.

- 1 janar 2019 SNRF 16 Qiratë
- 1 janar 2019 KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave
- 1 janar 2019 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative
- 1 janar 2019 Interesat afatgjata në bashkëpunëtorët dhe sipërmarrjet e përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)
- 1 janar 2019 Përmirësime vjetore të Standardeve të SNRF 2015-2017 Cikli - standarde të ndryshme
- 1 janar 2020 Ndryshime në Referenca për Kornizen Konceptual në Standardet e SNRF
- (data e shtyre paafat) Shitja ose Kontributi i Aseteve në mes të një Investitori dhe bashkëpunëtor ose ndërmarrje e përbashkët (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28)

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese dërgon në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Kompanisë apo pozitës dhe performancës financiare.

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

3. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (vazhdim)

3.2 Standardet dhe interpretimet në publikim akoma jo në fuqi

Nje numer i standardeve dhe ndryshimeve te standardeve jane efektive per periudhat qe fillojne pas date 1 Janar 2018 dhe adoptimi me i hershem eshte i lejueshem, sidoqoft kompania nuk e ka bere aplikimin e hershem te standardeve si me poshte ne pergaditjen e ketyre pasqyrave financiare:

- SNRF 16 Qeratë

IFRS (SNRF) 16 paraqet nje model te vetem te qerese ne pasqyre e pozicionit financiar per qiratë. Qiramarrësi e njuh të drejtën e përdorimit të asetit bazë dhe përfaqëson të drejtën e tij për ta përdorur asetin dhe te njuh një detyrim për qira, që përfaqëson obligimin për t'i bërë pagesat e qirasë. Ka përjashtime opsionale për qiratë afatshkurtëra dhe për qiratë e sendeve me vlerë të vogël. Kontabiliteti (regjistrimi) për qiradhënësin mbetet i njëjtë me standardin aktual, dmth qiradhënësi do të vazhdojë ta klasifikojë qiranë si qira financiare ose qira operative (të zakonshme).

IFRS (SNRF) 16 zëvendëson udhëzimet (standardet) ekzistuese për qiratë duke përfshirë SNK 17 Qiratë, IFRIC (KIRFN) 4 Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban qira, SIC (KIS) 15 Qiratë operative (e zakonshme) – Stimujt, SIC (KIS) 27 Vlerësimi i përmbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të një qiraje.

Ky standard është efektiv (hyn në fuqi) për periudhat që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019. Aplikimi (zbatimi) i mëhershëm është i lejuar për entitetet që zbatojnë IFRS (SNRF) 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët, më ose para datës fillestare të aplikimit të IFRS (SNRF) 16 Entiteti nuk pret që standardi i ri, kur aplikohet fillimisht, do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare për shkak se njësia ekonomike nuk është palë në një marrëveshje kontraktuale që hyn në fushën e SNRF 16.

Standarde te tjera

- KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave.
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshimet në SNRF 9).
- Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28).
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF 2015-2017 Cikli - standarde të ndryshme.
- Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNRF.

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

4.1 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur me parimin e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në EURO, e cila është monedha funksionale e kompanisë.

4.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Toka, Ndertesat dhe Makinerit jane te mbajtura ne pasqyrat e pozicionit financiare ne vleren e tyre te rivlersuara, sipas vlerese se tyre te dates se rivlersimit, zbritur per zhvlersimet e akumuluar dhe te shlyrjeve te munehme. Rivlersimi eshte bere sipas rregullave dhe metodave adekuate sikur qe vlera e mbetur e tyre nuk ka diferenca material nga ato qe do te percaktojne vleren e derjt te tregut ne fund te qdo periudhe.

Per te gjitha asetet e reja si: Prona, impiantet dhe pajisjet janë matur në kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje nga dëmtimi, nëse ka ndonjë (referojuni tek shënimi Nr. 5). Kosto përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Zhvlerësimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të jetëgjatësisë vlerësuar të secilës pasuri duke përdorur metodën lineare.

Pasuritë me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së tyre të dobishme. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitime të ardhshme të pasurisë specifike me të cilat ato lidhen.

Normat e zhvlerësimit të mëposhtme zbatohen për periudhat aktuale dhe krahasuese :

	2018	2017
Ndertesat	5%	5%
Pajimet dhe Makinerit	10%	10%
Mjetet transportuese	10%	10%
Pajisje dhe te tjera	20%	20%

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Qiratë e tjera janë qira operative për të cilat pasuritë me qira nuk janë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar të kompanisë. Pagesat e bëra për qiranë operative janë njohur në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në bazë të metodës lineare të afatit të qerasë.

4.3 Tatimi në fitim

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 03/L-162 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave"

Shpenzimet e tatimit për periudhën përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohura direkt në kapital ose në të hyra tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i shtyrë pasuri njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Tatimi i shtyrë pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që ajo nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Ngarkesa aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjeve tatimore në fuqi ose në datën e raportimit. Menaxhmenti periodikisht vlerëson qëndrimet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e zbatueshme tatimore janë subjekt i interpretimit. Ajo përcakton provizione kur është e nevojshme në bazë të shumave që pritet të paguhet në organet tatimore.

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
(Shumat në Euro)

4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.4 Stoqet

Stoqet janë njohur fillimisht sipas kostos ose vlerës së realizueshme neto, varësisht se cila është më e ulët. Kostoja përmban koston e blerjes, koston e shendërrimit, dhe të gjitha kostot shoqëruese të ndodhura për të sjelljë stoqet në vendin dhe gjendjen aktuale. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

4.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe në llogaritë operative në bankë me afat maturimi tre muaj ose më pak.

4.6 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare dhe shumat e tjera të pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar nëse i është faturuar Kompanisë apo jo.

4.7 Huazimet

Huazimet njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare kreditë dhe huazimet janë paraqitur me koston e amortizuar dhe çdo diferencë mes koston dhe vlerës së ripagesës njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse përgjatë periudhës së huazimit duke përdorur metoden efektive të interesit.

4.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto e kthimit të konsumatorëve, zbritjet dhe tatimet e lidhura me shitje.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë të përmbushura:

- Kompania ka transferuar tek blerësit rreziqet e rëndësishme dhe përfitimet e pronësisë së mallrave;
- Kompania nuk e ruan as përfshirjen e vazhdueshme menaxheriale në nivelin që zakonisht lidhet me pronësinë dhe as kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin të rrjedhin tek entiteti; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

4.9 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e kryerjes së transaksioneve. Në çdo datë të bilancit, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo monetarë që maten në termat e koston historike në monedhë të huaj nuk konvertohen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën lindin.

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.10 Rënia në vlerë

Vlera kontabël e pasurive të kompanisë, me përjashtim të stoqeve rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet kur vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Për një pasuri që nuk gjeneron rrjedha hyrëse të parasë të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përkasin pasuritë.

Në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet, një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme.

4.11 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit në bilancat e bankave të njohura në fitim ose humbje. Të hyrat nga interesi njihen si akruale, duke përdorur metodën efektive të interesit. Shpenzimet e interesit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të interesit.

4.12 Përfitimet e punonjësve

Kompania nuk ndan asnjë provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve më të madha se kontributet e paguara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

4.12 Kontingjentat dhe provizionet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveç nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Pasuria kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Provizioni është njohur nëse kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

4.15 Parimi i vazhdimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vazhdimësisë, e cila supozon realizimin e pasurive dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.

4.16 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim që ka ndikim të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

Supozimet kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kyçe të vlerësimit të pasigurisë në datën e raportimit, që rrezikojnë të shkaktojnë një rregullim material në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, janë diskutuar më poshtë:

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
(Shumat në Euro)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.16. Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar (vazhdim)

Detyrimi aktual tatimor

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018 i nënshtrohen inspektimit nga autoritetet tatimore vendore, ku menaxhmenti i Kompanisë ka përdorur vlerësimin dhe gjykimin e tij më të mirë, për të qenë në përputhje me ligjet tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykimin për të përmbushur kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimi tatimor më 31 dhjetor 2018 mund të ndryshojë në krahasim me atë të raportuar në këto pasqyra financiare.

Provizioni për dëmtim të llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stokeve

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësim për rikuperimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stokeve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stokeve. Faktoret dhe rrethanat e shqyrtuara nga menaxhmenti me datën e raportimit nuk rezultojnë në provizionim të llogarive të arkëtueshme dhe stokeve.

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

5. Prona, impiantet dhe pajisjet

	Ndertesa dhe rruge	Pajisje dhe makineri	Mjete transportuese	Pajisje dhe te tjera	Total
Kosot historike					
Më 1 Janar 2017	821,664	12,910,191	1,100,841	5,314,801	20,147,497
Shtesat	-	310,624	-	-	310,624
Largimet	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	821,664	13,220,815	1,100,841	5,314,801	20,458,121
Më 1 Janar 2017	821,664	13,220,815	1,100,841	5,314,801	20,458,121
Shtesat	-	677,855	-	-	677,855
Largimet	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	821,664	13,898,670	1,100,841	5,314,801	21,135,976
Zhvlersimi I akumuluar					
Më 1 Janar 2017	(91,281)	(6,427,088)	(889,296)	(93,795)	(7,501,460)
Shtesat	(13,397)	(653,418)	(104,942)	(5,754)	(777,511)
Largimet	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	(104,678)	(7,080,506)	(994,238)	(99,549)	(8,278,971)
Më 1 Janar 2017	(104,678)	(7,080,506)	(994,238)	(99,549)	(8,278,971)
Shtesat	(13,397)	(530,187)	-	-	(543,584)
Rregullim	-	21,772	-	-	21,772
Më 31 dhjetor 2018	(118,075)	(7,588,921)	(994,238)	(99,549)	(8,800,783)
Vlera neto ne libra 1 janar 2017	730,383	6,483,103	211,545	5,221,006	12,646,037
Vlera neto ne libra 31 dhjetor 2017	716,986	6,140,309	106,603	5,215,252	12,179,150
Vlera neto ne libra 31 dhjetor 2018	703,589	6,309,749	106,603	5,215,252	12,335,193

6. Stoqet

Stoqet me 31 Dhjetor 2018 prej perbehen nga si vijon:

Stoqet	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Stoqet e lendes se pare dhe materialit	569,152	733,518
Stoqet e gjysemprodukteve	15,808	7,534
Stoqet e produkteve te gatshme	153,440	12,085
Total	738,400	753,137

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

7. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si në vijim:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Konsumatorët vendor	344,545	1,274,385
Konsumatorët e huaj	645,497	1,464,403
	990,042	2,738,788
Tjera	201,400	195,080
Parapagimi i Tvsh-se	308,215	986,087
Total	509,615	1,181,167
Gjithsej	1,499,657	3,919,955

8. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si në vijim:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Para në bankë	792,348	1,910,172
Para në arkë	801	4,462
Gjithsej	793,149	1,914,634

9. Kapitali aksionar dhe rezerva e rivleresimit

Kapital aksionar i kompanise me 31 Dhjetor 2018 eshte EUR 22,808,174 (31 Dhjetor 2017: EUR 22,808,174).

10. Detyrimet tjera afatgjata

Detyrimet afatgjata perbehen nga si vijon:

Detyrimet afatgjata	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Avancat e marra	917,375	615,564
Te hyrat per investime kapitale nga BKK	2,881,857	2,628,816
Total	3,799,232	3,244,380

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

11. Të pagueshmet tregtare dhe detyrimet tjera

Të pagueshmet tregtare dhe detyrimet tjera me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si në vijim:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Detyrime te furnitoret	2,344,883	4,161,799
Detyrime tjera	171,446	76,196
Totali	2,516,329	4,237,995

12. Detyrimet ndaj te punesuarve dhe tatimeve

Detyrimet ndaj te punesuarve dhe tatimeve me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë të përbëra si në vijim:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Neto pagat e pagueshme	863,541	886,762
Ndalesat per anetarsi sindikale nga neto pagat	6,745	7,669
Tatimi ne paga	64,949	73,700
Kontributi per TKPK- punetori	48,998	54,398
Kontributi per TKPK- punedhenesi	(545)	54,398
Total	983,688	1,076,927

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

13. Te hyrat

Te hyrat përbëhen si në vijim:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Te hyrat nga shitja e koncentratit te zinkut	3,431,585	6,110,403
Te hyrat nga shitja e koncentratit te plumbit	6,129,329	8,388,372
Te hyrat nga shitja e aluminiut sulfatit	172,050	138,578
Te hyrat nga shitja e mbeturinave	1,984,829	1,334,522
Te hyrat e tjera	-	31,503
Gjithsej	11,717,793	16,003,378

Te hyrat tjera	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Te hyrat nga shërbimet per palet e treta	19,447	89,469
Te hyrat nga qiraja nga ndertesat	95,856	97,282
Te hyrat nga qiraja e pajisjeve	291,736	136,380
Gjithsej	407,039	323,131
Gjithsej te hyrat	12,124,832	16,326,509

14. Te hyrat tjera financiare

Te hyrat tjera financiare përbëhen si në vijim:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Subvencionet per paga dhe stipendione nga BKK	2,158,009	2,158,009
Mjete te BKK per investime kapitale	1,051,034	1,558,661
Fitimet nga shkembimet valutore	62,237	24,722
Gjithsej	3,271,280	3,741,392

15. Shpenzimet e personelit

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Pagat dhe rrogat	11,814,966	12,345,744
Sigurimi shoqëror	590,145	616,995
Gjithsej	12,405,111	12,962,739

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

16. Shpenzimet tjera operative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative përbëhen si në vijim:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Mirembajtje dhe riparime	137,218	91,977
Shpenzimet tjera administrative	213,702	158,818
Shpenzimet e transportit	229,372	200,073
Shpenzimet e ushqimit te punetoreve	456,139	447,461
Komunalite	177,870	103,849
Stipendionet e punetoreve	274,901	278,700
Shpenzimet e tjera	106,331	108,297
Total	1,595,533	1,389,175

17. Tatimi në fitim

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	(2,211,138)	1,187,194
Shpenzime te pazbritshme	-	-
(Humbja) fitimi baze per tatim	(2,211,138)	1,187,194
Tatimi ne fitim	(2,211,138)	118,719

Tatimi në fitim në Kosovë është në normën prej 10% në vitin 2018 (2017: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

Trepça SHA

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2018
(Shumat ne Euro)

18. Zotimet dhe kontingjentet

(i) Zotimet

Kompania nuk ka hyrë në zotime dhe kontingjenca per vitin më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

(ii) Kontestet

Me 31 dhjetor 2018 Kompania është e përfshirë në çështje gjyqësore nga aktiviteti normal i biznesit so pale e paditur. Si me 31 dhjetor 2018 kompania nuk ka njohur ndonje detyrim per rastet gjyqësore te mundshme per tu humbur.

19. Instrumentet financiare

(i) Rreziku kreditor

Instrumentet financiare të cilat potencialisht e ekspozojnë kompaninë ndaj përqendrimeve të rrezikut kreditor përbëhen kryesisht nga balancat e të arkëtueshmeve dhe të parave të gatshme. Ekspozimi i Kompanisë ndaj rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Kompania ka krijuar një politikë kreditore nën të cilën secili klient i ri analizohet individualisht për besueshmëri para se termet dhe kushtet e pagesës dhe të dërgesës të ofrohen. Rreziku kreditor i të arkëtueshmeve kontrollohet me anë të aprovimeve të arkëtueshmeve dhe shpenzimeve buxhetore që i gjenerojnë të arkëtueshmet e tilla.

Rreziku kreditor në paratë e gatshme kontrollohet duke investuar në bankat me reputacion në Kosovë.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe ato të Kosovës

Kriza e vazhdueshme botërore financiare dhe kriza ekonomike ka rezultuar në, ndër të tjera, një nivel më të ulët të financimit të tregut të kapitaleve, nivele më të ulëta të likuiditetit në sektorin bankar, dhe, kohë pas kohe, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri më të lartë në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet globale financiare kanë rezultuar edhe në dështime të bankave dhe shpëtime të bankave në të gjithë botën. Shtrirja e plotë e ndikimit të krizës financiare së vazhdueshme po dëshmon të jetë e pamundur për t'u parashikuar ose për tu mbrojtur plotësisht nga ajo.

(ii) Rreziku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutave të huaja pasi që shumica e fondeve pranohen dhe shpenzohen në Euro. Kompania nuk përdor instrumente derivative për të shmangur ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të huaj.

(iii) Vlera e drejtë

Kompania ka pasuri financiare të cilat përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj. Kompania ka detyrime financiare të cilat përbëhen nga akrualet, të pagueshmet e tjera. Vlerat e drejta të këtyre instrumenteve financiare nuk janë materialisht të ndryshme nga vlera e tyre e deklaruar për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër ose kushteve të tjera.

(iv) Rreziku i normës së interesit

Të ardhurat e kompanisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut duke pasur parasysh se shumica e financimit sigurohet nga kompania mëmë.